

5 shkurt 2004

RREGULLORE NR. 2004/2
MBI PENGIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE VEPRAVE TË NGJASHME
PENALE

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999) të datës 10 qershor 1999,

Duke pasur parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke ditur se pastrimi i parave kërcënon zhvillimin ekonomik, sundimin e së drejtës, sigurinë, stabilitetin dhe kontribuon në krijimin e një klime të përshtatshme për krim të organizuar, korrupsion dhe terrorizëm.

Me qëllim të krijimit të një kornize ligjore për pengimin dhe zbulimin e të gjitha formave të pastrimit të parave dhe aktiviteteve të ngjashme në Kosovë,

Shpall sa vijon:

Neni 1
Përkufizimet

Sipas kësaj Rregulloreje:

1.1 “Avokat” do të thotë anëtar i Shoqatës së Avokatëve të Kosovës apo të Serbisë dhe Malit të Zi, i cili e ushtron profesionin e avokatit në Kosovë;

1.2 “Rregullorja për veprimet bankare” do të thotë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 199/21 e datës 15 nëntor 1999 mbi licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave;

1.3 “Bankë” do të thotë subjekti i përkufizuar si bankë në Rregulloren mbi veprimet bankare;

- 1.4 “Përfitues” do të thotë person ose subjekt që ka të drejtë në posedim, shfrytëzim ose tjetërsim të pronës, edhe pse personi apo subjekti nuk ka bazë juridike ose nuk është posedues a shfrytëzues aktual i pronës. E drejta e tillë mund të jetë paraparë në ligj ose në marrëveshjen e arritur ndërmjet përfituesit dhe pronarit ose poseduesit ligjor e cila nuk duhet të zbatohet ligjërisht.
- 1.5 “BPK” do të thotë Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës;
- 1.6 “Rregullorja mbi BPK-në” do të thotë Rregullorja e ndryshuar e UNMIK-ut nr. 1999/20 e datës 15 nëntor 1999 mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave në Kosovë;
- 1.7 “Organizatë afariste” do të thotë personi apo personat e përkufizuar si organizatë biznesi në nenin 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/6 të datës 8 shkurt 2001 mbi organizatat e biznesit;
- 1.8 “Kontabilist i certifikuar” do të thotë kontabilist i certifikuar nga një shoqatë profesionale e kontabilitetit në pajtim me nenin 6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/30 të datës 29 tetor 2001 për Themelimin e Bordit të Kosovës mbi standardet e raportimit financiar dhe regjimit të raportimit financiar të organizatave afariste;
- 1.9 “Klient” do të thotë personi ose subjekti i cili kryen transaksione ose shfrytëzon shërbimet e një banke, të një institucioni financiar, të një përfaqësuesi ligjor, të një kontabilisti të certifikuar ose të një revizori të licencuar. Shprehja “klient” përfshin personin ose subjektin i cili kryen transaksione ose pranon shërbime nga një bankë, institucion financiar, përfaqësues ligjor, kontabilist të certifikuar ose revizor të licencuar, si dhe çdo pronar, përfitues, person a subjekt tjetër në emër të të cilit kryhet transaksioni ose pranohen shërbimet;
- 1.10 “Valutë” do të thotë mjet, duke përfshirë edhe monedhën dhe bankënotën që qarkullon si mjet këmbimi në Kosovë ose gjetiu;
- 1.11 “Subjekt” do të thotë subjekti që ekziston në formë të organizuar ligjore, i cili mes tjerash përfshin: personin juridik, organizatën afariste, OJQ-në, partinë politike, trustin, ndërmarrjen shoqërore dhe ndërmarrjen publike;
- 1.12 “Institucion financiar” do të thotë subjekt, përpos bankës, që si ndërmarrje komerciale drejton një apo më shumë nga aktivitetet apo veprimet e mëposhtme:
- (a) Pranimin e depozitave ose fondeve të tjera të kthyeshme nga qytetarët;
 - (b) Huadhënien, duke përfshirë mes tjerash kreditet për konsumatorë; kredinë për hipotekë; faktorimin me ose pa të drejtë tërheqjeje dhe financimin e transaksioneve komerciale (duke përfshirë edhe humbjen);

(c) Transmetimin e parasë ose të instrumenteve monetare në çdo mënyrë, duke përfshirë edhe sistemin e transferit jozyrtar të parave ose me anë të rrjetit të personave a subjekteve të cilët mundësojnë transferimin e parave jashtë sistemit tradicional të institucioneve financiare;

(d) Këmbimin e parave ose monedhave;

(e) Caktimin dhe menaxhimin e mënyrave të pagesës, duke përfshirë këtu por jo të limituar në kreditë edhe kartelat debitore, çeqet, çeqet e udhëtarëve, urdhërpagesat, planin e bankarëve ose paratë elektronike;

(f) Dhënien e garancioneve financiare dhe zotimeve;

(g) Tregtimin në emër të individit dhe në emër të personave ose subjekteve të tjera në një apo më shumë nga sa vijon:

(i) Instrumentet e tregut të parasë (çeqet, bankënotat, certifikatat e depozitave, letrat me vlerë etj.);

(ii) Këmbimin e jashtëm;

(iii) Këmbimin, shkallën e interesit dhe instrumentet e indeksit;

(iv) Letrat me vlerë të transferueshme dhe

(v) Tregtimin e mallrave me transaksione të afatizuara;

(h) Menaxhimi i portofolit individual dhe kolektiv;

(i) Pjesëmarrja në emetimin e letrave me vlerë dhe sigurimi i shërbimeve financiare lidhur me këto emetime;

(j) Ruajtja dhe administrimi i parave të gatshme ose letrave me vlerë likuide në emër të personave apo subjekteve të tjera, përveç nëse personi i angazhuar në veprimtari është avokat, kontabilist i certifikuar ose revizor i licencuar;

(k) Investimi, administrimi ose menaxhimi i fondeve apo parave në emër të personave ose subjekteve të tjera, përveç nëse personi i angazhuar në veprimtari është avokat, kontabilist i certifikuar ose revizor i licencuar;

(l) Të vepruarit si kompani e sigurimeve, kompani e risigurimeve ose si ndërmjetës i sigurimeve siç është përkufizuar në nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/25 të datës 5 tetor 2001 mbi licensimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e kompanive dhe ndërmjetësve të sigurimit dhe

(m) Të vepruarit si fiduciar siç është përkufizuar në nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/35 të datës 22 dhjetor 2001 mbi pensionet në Kosovë;

1.13 “Pasuri e paluajtshme” do të thotë toka, ndërtesat dhe banesat;

1.14 “E drejta në pasuri të paluajtshme” do të thotë e drejta që lidhet me pasurinë e paluajtshme, duke përfshirë edhe pronësinë, hipotekën, servitudet dhe të drejtat për shfrytëzimin e pasurisë shoqërore, publike dhe shtetërore;

1.15 “KFOR” do të thotë prania ndërkombëtare për siguri e themeluar në pajtim me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit në territorin e Kosovës;

1.16 “Revizor i licencuar” do të thotë personi i licencuar si revizor në pajtim me nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/30 të datës 29 tetor 2001 mbi themelimin e Bordit të Kosovës për standardet e raportimit financiar dhe regjimin për raportim financiar të organizatave të biznesit;

1.17 “Instrument monetar” do të thotë monedha; çeqet për udhëtim’ çeqet personale; çeqet e bankave; urdhërpagesat; mandapostat; çeqet e bankave me firmën e arkatarit të çdo lloji dhe letrat me vlerë për investime ose instrumentet e transferueshme në formë të bartësit ose në formë tjetër të tillë që titulli t’i kalohet me rastin e dërgimit;

1.18 “Pastrim i parave ” do të thotë vepër penale e përkufizuar në nenin 10.2;

1.19 “OJQ” do të thotë subjekti i përkufizuar si organizatë joqeveritare në nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/22 të datës 15 nëntor 1999 mbi regjistrimin dhe veprimin e organizatave joqeveritare në Kosovë;

1.20 “Policia” do të thotë Policia Civile e UNMIK-ut si dhe Shërbimi Policor i Kosovës që vepron nën mbikëqyrjen e Policisë së UNMIK-ut;

1.21 “Vepër e ndërlidhur penale” do të thotë vepër penale e dënueshme me një apo me më tepër vjet burgim sipas ligjit në fuqi në Kosovë ose sipas juridiksionit në të cilin është kryer vepra penale;

1.22 “Të ardhurat nga vepra penale” do të thotë çdo pasuri e përfituar në mënyrë direkte apo indirekte nga vepra e ndërlidhur penale. Pasuria e fituar në mënyrë direkte nga vepra e ndërlidhur penale përfshin pasurinë në të cilën çdo pasuri e përfituar në mënyrë direkte nga vepra e ndërlidhur penale më vonë është konvertuar, transformuar ose është ngatërruar, si dhe të ardhurat, kapitali apo përfitimet tjera ekonomike të realizuara nga pasuria e tillë në çfarëdo kohe të kryerjes së veprës penale.

1.23 “Pasuri” përfshin pasurinë e çfarëdo lloji, qoftë materiale apo jomateriale, të luajtshme apo të paluajtshme dhe dokumentet ligjore ose instrumentet të cilat dëshmojnë të drejtën në pasurinë apo interesin në pasurinë e tillë;

1.24 “Veprim ose transaksion i dyshimtë” do të thotë veprim ose transaksion nga i cili buron dyshimi i arsyeshëm se pasuria e përfshirë në veprim ose transaksion është pasuri e fituar me vepër penale. Udhëzimet lidhur me përmbajtjen e veprimeve dhe aksioneve të tilla mund të nxirren nga Qendra Informativë Financiare;

1.25 “Aktivitetet terrorist” do të thotë vepër penale nga neni 2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/12 e datës 14 qershor 2001 mbi ndalimin e terrorizmit dhe veprave të ngjashme dhe

1.26 “UNMIK” do të thotë prania ndërkombëtare civile e vendosur në pajtim me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashuara në territorin e Kosovës, duke inkorporuar Shtyllën e Policisë dhe të Drejtësisë; Administratën e Përkohshme Civile (Kombet e Bashkuara); Shtyllën e Krijimit të Institucioneve (OSBE) dhe Shtyllën e Rindërtimit dhe Zhvillimit Ekonomik (UE).

Neni 2

Autoriteti i Qendrës së Informimit Financiar

2.1 Qendra e Informimit Financiar (“Qendra”) është themeluar në kuadër të Shtyllës së Policisë dhe Drejtësisë. Ajo do të financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Shefi i Qendrës do të emërohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm me rekomandimin e zëvendësit të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Polici dhe Drejtësi. Qendra i dorëzon raporte zëvendësit të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm çdo tre muaj. Përbërja dhe struktura e Qendrës do të përcaktohet me urdhëresë administrative. Kjo Qendër është e autorizuar të:

(a) Pranojë dhe analizojë raporte dhe informacione:

(i) Të përgatitura apo të ruajtura sipas nenit 3 deri në nenin 9,

(ii) Të siguruara për Qendrën, nga organet e përgjegjshme për zbatimin e ligjit (duke përfshirë edhe INTERPOLIN ose çdo organ tjetër ndërkombëtar apo ndërqeveritar), institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes, UNMIK-un ose KFOR-in dhe

(iii) Të dhëna dhe raporte lidhur me dyshimin e pastrimit të parave apo financimin e aktiviteteve terroriste, të cilat në mënyrë vullnetare i janë siguruar Qendrës;

(b) Grumbullojë të dhëna të cilat janë relevante për aktivitetet e pastrimit të parave ose financimin e aktiviteteve terroriste të cilat gjenden publikisht, madje edhe përmes bazës së të dhënave që është në dispozicion në mënyrë komerciale;

(c) Me qëllim të analizimit të dyshimit të larjes së parave ose financimin e aktiviteteve terroriste, Qendra do të kërkojë shënime dhe informacione nga cilido institucion i përkohshëm i vetëqeverisjes ose nga UNMIK-u lidhur me personin,

subjektin, pasurinë ose transaksionin, ku agjencitë menjëherë e sigurojnë informacionin e kërkuar, përpos nëse në mënyrë të qartë është e ndaluar me ligj;

(d) Krijon dhe mirëmban bazën e të dhënave me të gjitha informacionet e mbledhura ose të pranuar lidhur me dyshimin për pastrimin e parave ose financimin e aktiviteteve terroriste, si dhe materiale të tjera të ngjashme relevante për punën e Qendrës;

(e) Në pajtim me marrëveshjet, këmben dhe kërkon informacione me organet e përgjegjshme për zbatimin e ligjit jashtë Kosovës lidhur me dyshimin për pastrimin e parave apo financimin e aktiviteteve terroriste;

(f) Grumbullon të dhëna statistikore e shënime dhe në bazë të tyre i bën rekomandime ministrit të Financave dhe të Ekonomisë, zëvendësit të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Polici dhe Drejtësi, drejtorit të Departamentit të Drejtësisë, policisë dhe Shërbimit të Doganave në Kosovë lidhur me masat të cilat mund të ndërmerren dhe ligjet të cilat mund të miratohen për luftimin e larjes së parave dhe financimin e aktiviteteve terroriste;

(g) Shpall publikisht raportet e tilla të dobishme për përmbushjen e detyrave;

(h) Në konsultim me policinë dhe Shërbimin Doganor të Kosovës udhëheq programe trainimi për institucionet qeveritare, subjektet dhe personat të cilët i nënshtrohen kësaj Rregulloreje lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e aktiviteteve terroriste;

(i) Në pajtim me nenet 2.2 dhe 2.3 autoriteteve relevante u shpërndan raporte dhe informacione;

(j) Në pajtim me nenet 2.4 deri në nenin 2.7 mbikëqyr përputhshmërinë me këtë Rregullore;

(k) Përpilon formularë dhe udhëzime të cilat përdoren për raportimin e të dhënave në Qendër në pajtim me këtë Rregullore dhe

(l) Nxjerr urdhëresa administrative, udhëzime dhe udhëzues mbi çështjet që ndërlidhen me sigurimin dhe promovimin e përputhshmërisë me këtë Rregullore, duke përfshirë mes tjerash: (i) përdorimin e formularëve të standardizuar të raportimit; (ii) llojin e akteve ose të transaksioneve të dyshimta për qëllimet e kësaj Rregulloreje, duke përfshirë edhe përpilimin e listave të treguesve të akteve dhe transaksioneve të tilla dhe (iii) përjashtimin e personave, subjekteve ose kategorive të personave a subjekteve nga raportimi i detyrimeve sipas kësaj Rregulloreje dhe metodat mbi raportimin e përjashtimeve të tilla.

Shpalosja dhe shpërndarja e informacioneve dhe shënimeve

2.2 Qendra do të shpalojë vetëm informacionet vijuese ose shënimet që përfshijnë informacione të tilla në pajtim me nenin 2.3:

(a) Çdo të dhëne që ka të bëjë me personin ose subjektin që i nënshtrohet raportit të ruajtur nga Qendra, që në mënyrë direkte apo indirekte do të identifikonte personin ose subjektin duke përfshirë mes tjerash emrin dhe adresën;

(b) Çdo të dhëne identifikuese lidhur me një transaksion, duke përfshirë mes tjerash datën, vendin, sasinë ose llojin e pasurisë, numrin e xhirollogarisë ose numrin e transaksionit dhe

(c) Çdo të dhëne lidhur me një person a subjekt i cili i ka siguruar të dhëna ose shënime Qendrës të cilat në mënyrë direkte apo indirekte identifikojnë personin apo subjektin.

2.3 Informacionet nga neni 2.2 mund të shpalosen nga Qendra vetëm nën rrethanat e poshtëshënuara:

(a) Njësisë përkatëse të policisë, njësisë hetimore financiare, prokurorit publik kompetent, Shërbimit Doganor të UNMIK-ut, Departamentit të Administratës Tatimore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ose KFOR-it, nëse informatat e tilla do të ishin relevante për hetimet brenda kompetencave të saj, ose një organi jashtë Kosovës me funksione të ngjashme me Qendrën e në pajtim me një marrëveshje të arritur me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm;

(b) Cilitdo nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes ose UNMIK-ut, nëse shpalosja e tillë e të dhënave është e nevojshme për Qendrën për të marrë informacione në pajtim me nenin 2.1(c);

(c) Organeve të përgjegjshme për zbatimin e ligjit jashtë Kosovës, nëse shpalosja e tillë është e nevojshme për marrjen e informacioneve në pajtim me nenin 2.1(e) dhe

(d) Bordit mbikëqyrës përkatës, nëse gjatë kryerjes së funksioneve në pajtim me nenet 2.4 deri në nenin 2.6 dhe nëse Qendra ka dyshim të bazuar se ka pasur shkelje të neneve 3 deri në nenin 7.

Mbikëqyrja

2.4 Zyrtares ose zyrtarët e autorizuar, të caktuar të punojnë në Qendër, mund të hyjnë në lokale në çdo kohë gjatë orarit të rregullt të punës, përveç rezidencës, nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se në të ka shënime të cilat ruhen në pajtim me nenet 3 deri në nenin 7 ose dokumente relevante për të përcaktuar nëse janë përmbushur detyrimet nga nenet 3 deri në nenin 7. Zyrtares ose zyrtarët e autorizuar mund të kërkojnë inspektim të shënimeve ose dokumenteve, të kopjojnë ose të nxjerrin shënim ose dokument të tillë dhe të shtrojnë pyetje për të përcaktuar dhe kuptuar shënimet ose dokumentet e tilla. Zyrtares

ose zyrtarët e autorizuar do ta kufizojnë inspektimin në atë pjesë të lokalit në të cilin ka gjasa të arsyeshme të gjenden shënimet a dokumentet relevante dhe ata do të ndërmarrin veprime të cilat janë të nevojshme për qëllim të inspektimit dhe në proporcion me qëllimin e inspektimit të shënimeve të tilla.

2.5 Nëse zyrtari ose zyrtarët e autorizuar me arsye besojnë se shënimet e ruajtura në pajtim me nenet 3 deri në nenin 7 ose dokumentet relevante për të përcaktuar nëse detyrimet nga neni 3 deri në nenin 7 janë përmbushur dhe gjenden në rezidencë, zyrtari ose zyrtarët e autorizuar mund të hyjnë në rezidencë për t'i kryer detyrat e tyre në pajtim me nenin 2.4,

(a) Me pëlqimin e mbajtësit të rezidences ose

(b) Në pajtim me urdhrin e lëshuar nga gjyqtari hetues i Gjykatës së Qarkut ku ndodhet rezidenca. Gjyqtari hetues lëshon urdhër të tillë me propozim të ndonjë zyrtari të autorizuar të Qendrës në interes të një pale nëse ai ose ajo konstaton se:

(i) Ekziston shkak i arsyeshëm për të besuar se në rezidencë ka shënime të ruajtura në pajtim me nenet 3 deri në nenin 7 ose dokumente relevante për të përcaktuar nëse janë përmbushur detyrimet nga nenet 3 deri në nenin 7;

(ii) Hyrja në rezidencë është e nevojshme për çfarëdo qëllimi që ndërlihet me sigurimin e përputhshmërisë me nenet 3 deri në nenin 7 dhe

(iii) Hyrja në rezidencë është refuzuar ose ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se do të refuzohet.

2.6 Pronari ose personi përgjegjës i lokaleve të cilat inspektohen dhe çdo person i pranishëm në lokal u ofron zyrtarëve të autorizuar tërë ndihmën e arsyeshme për t'iu mundësuar atyre të kryejnë detyrat e tyre, duke përfshirë edhe identifikimin e shënimeve apo dokumenteve relevante dhe dhënien e informacioneve të kërkuara për t'iu mundësuar zyrtarit të autorizuar përcaktimin dhe kuptimin e shënimeve apo dokumenteve të tilla. Personat e tillë gjithashtu do të ndihmojnë zyrtarët e autorizuar për të hyrë në lokal, për të kopjuar apo për të nxjerrë shënimet ose dokumentet e ruajtura në mënyrë elektronike dhe do të lejojnë përdorimin e çdo pajisje për kopjim të vendosur në lokal.

2.7 Personi i ndodhur në lokal i cili i nënshtrohet inspektimit në pajtim me nenet 2.4 deri në nenin 2.6 mund të refuzojë lejimin e inspektimit ose kopjimin e shënimeve apo të dokumenteve nëse ai ose ajo pohon se:

(a) Nuk është ruajtur në pajtim me nenet 3 deri në nenin 7 dhe nuk është relevante për të përcaktuar nëse janë përmbushur detyrimet nga nenet 3 deri në nenin 7 ose

(b) Përmban informacione që i nënshtrohen të drejtës së posaçme avokat - klient.

Nëse ndodh një refuzim i tillë, zyrtari i autorizuar i cili e drejton inspektimin, e vendos shënimin ose dokumentin kontestues në zarf apo në kuti tjetër të përshtatshme, e cila mbyllet në prani të personit apo përfaqësuesit të tij a të saj ligjor dhe nënshkruhet nga zyrtari e nga personi apo përfaqësuesi. Shënimi ose dokumenti i mblyllur i dorëzohet gjyqtarit hetues në gjykatën kompetente të qarkut brenda 10 ditëve, i cili do ta inspektojë atë dhe do të përcaktojë nëse ai, në cilëndo pjesë të tij, i nënshtrohet inspektimit dhe kopjimit në pajtim me këtë nen.

2.8 Nëse personi konsideron se ai ose ajo ka qenë subjekt i veprimeve nga nenet 2.4 dhe 2.5 të cilat janë të paligjshme, ai ose ajo mund të paraqesë ankesë tek gjyqtari hetues i gjykatës kompetente të qarkut brenda 30 ditëve nga dita e inspektimit, i cili do të gjykojë ligjshmërinë e veprimeve në ankesë dhe do të vendosë për kompensim sipas nevojës. Zyrtarët e autorizuar të Qendrës i sigurojnë gjyqtarit hetues dokumente me kërkesën e tij ose të saj dhe, nëse kërkohet, ofrojnë edhe dëshmi gojore.

2.9 Pushteti i Qendrës sipas këtij neni i nënshtrohet Konventës mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Kombeve të Bashkuara të datës 13 shkurt 1946 dhe Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47 të datës 18 gusht 2000 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetet e KFOR-it, UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë.

Neni 3

Obligimet e bankave dhe institucioneve financiare

Identifikimi i klientëve

3.1 Bankat dhe institucionet financiare do të verifikojnë emrin, adresën kurse në rastin e personave, datën e lindjes të të gjithë klientëve para:

- (a) Hapjes së xhirologarisë;
- (b) Marrjes së stoqeve, detyrimeve ose letrave të tjera me vlerë në ruajtje të sigurt;
- (c) Dhënies së objekteve për dhoma të kasafortave dhe
- (d) Përfshirjes në një transaksion në para prej më shumë se 10.000 eurosh. Transaksionet e shumta në para do të trajtohen si transaksion i vetëm nëse banka ose institucioni financiar është në dijeni se transaksionet janë udhëhequr nga një person apo në emër të një personi ose subjekti dhe shuma e përgjithshme për një ditë është më shumë se 10.000 euro.

3.2 Personi i angazhuar në transaksion sipas nenit 3.1 vërteton me shkrim në bankë ose në institucionin financiar, në formatin e përcaktuar nga BPK-ja se vepron:

(a) Në emër të tij ose të saj si pronar dhe përfitues i çfarëdo pasurie e cila i nënshtrohet transaksionit ose

(b) Si përfaqësues i autorizuar i një apo më shumë personave a subjekteve të identifikuar sipas neneve 3.3 ose 3.4, që ka marrë hapat e arsyeshëm për të verifikuar se çdo person ose subjekt i identifikuar është pronar apo përfitues i çfarëdo pasurie, e cila i nënshtrohet transaksionit, dhe beson në mirëbesim se çdo person ose subjekt i identifikuar është pronar a përfitues i çfarëdo pasurie e cila i nënshtrohet transaksionit.

3.3 Emri i personit verifikohet me dorëzimin e një dokumenti zyrtar në formë origjinale me datë të paskaduar i cili përmban fotografinë e personit të tillë. Adresa dhe data e lindjes së personit verifikohet me dorëzimin e një dokumenti apo dokumenteve të cilat janë në gjendje për ta dëshmuar këtë.

3.4 Identiteti i çdo subjekti verifikohet me dorëzimin e:

(a) Certifikatës për regjistrimin e veprimtarisë afariste të lëshuar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/6 të datës 8 shkurt 2001 mbi organizatat afariste;

(b) Certifikatës për regjistrimin e një OJQ-je të lëshuar në pajtim me nenin 4.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/22 të datës 15 nëntor 1999 mbi regjistrimin dhe veprimin e organizatave joqeveritare në Kosovë;

(c) Certifikatës për regjistrimin e një partie politike të lëshuar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/8 të datës 4 prill 2002, mbi ndryshimin e Rregullores së ndryshuar nr. 2000/16 për regjistrimin dhe veprimin e partive politike në Kosovë ose

(d) Kur subjekti nuk është organizatë afariste, OJQ a parti politike, çfarëdo dokumenti apo dokumente të tjera të cilat mundësojnë verifikimin e identitetit të subjektit, formën ligjore, adresën, drejtorët dhe dispozitat që rregullojnë pushtetin e përfaqësuesve, zyrtarët dhe drejtorët për detyrimin e subjektit.

3.5 Çdo person i cili vepron si përfaqësues i autorizuar do të prezentojë dokumentet në pajtim me nenet 3.3 dhe 3.4 për vete dhe për personin ose subjektin që e ka autorizuar dhe do të sigurojë dokument me të cilin autorizohet ai ose ajo për udhëheqjen e transaksioneve në emër të personit a të subjektit të tillë.

3.6 Pamvarësisht nga përputhshmëria me nenet 3.2 deri në nenin 3.5, banka ose institucioni financiar do të ndërmarrin masa të arsyeshme e të nevojshme shtesë për identifikimin e çdo personi apo subjekti në emër të të cilit vepron personi i angazhuar në transaksion sipas nenit 3.1, duke përfshirë edhe pronarin dhe përfituesin e pasurisë.

3.7 Nëse banka ose institucioni financiar nuk mund të verifikojë identitetin e klientit, përfundohet marrëdhënia e veprimtarisë afariste, mbyllet çfarëdo xhirrollogarie dhe pasuria kthehet tek burimi i vet. Veprimet e tilla nuk do të kenë pasoja në detyrimet e bankës ose të institucionit financiar për të raportuar për aktet apo transaksionet e

dyshimta në pajtim me nenin 3.9 dhe për të raportuar mbi informacione të tjera shtesë në pajtim me nenin 3.10.

3.8 Bankat dhe institucionet financiare do të bëjnë kopje të të gjitha dokumenteve të prezentuara nga nenet 3.1 deri në nenin 3.5 dhe do t'i ruajnë ato së paku pesë vjet pas mbylljes së xhirollogarisë apo përfundimit të relacioneve me klientin, varësisht se cila ndodh më vonë.

Raportimi

3.9 Bankat dhe institucionet financiare do t'i raportojnë Qendrës në mënyrën dhe formën e përcaktuar nga Qendra:

(a) Për të gjitha aktet ose transaksionet e dyshimta brenda 24 orëve nga koha e identifikimit të aktit apo transaksionit si të dyshimtë dhe

(b) Për të gjitha transaksionet e vetme në para prej 10.000 eurosh ose më tepër. Transaksionet e shumta do të trajtohen si një veprim i vetëm nëse banka apo institucioni financiar është në dijeni se transaksioni është kryer nga një person apo në emër të një personi a subjekti dhe shuma e përgjithshme është më shumë se 10.000 eurosh për një ditë.

3.10 Bankat dhe institucionet financiare do të vazhdojnë t'i raportojnë Qendrës për çfarëdo materiali shtesë lidhur me transaksion(et)in që është marrë nga banka ose institucioni financiar pas dorëzimit të raportit nga neni 3.9.

3.11 Qendra mund të përjashtojë transaksione të caktuara ose kategori të transaksioneve nga detyrimet e nenit 3.9 qoftë me kërkesë të shkruar apo me iniciativë të vet kur veprimet bankare ose kategoritë e veprimeve bankare janë rutinore ose shërbejnë për një qëllim legjitim dhe nëse nuk janë në interes për mandatin e Qendrës. Përjashtimet e tilla do të bëhen me shkrim dhe kopjet e tyre do t'i dërgohen zëvendësit të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Polici dhe Drejtësi brenda 24 orëve nga nxjerrja e tyre. Vendimi i Qendrës për refuzimin e kërkesës për përjashtim është përfundimtar dhe nuk i nënshtrohet ankesës.

3.12 Drejtorët, zyrtarët, punëtorët dhe përfaqësuesit e cilësdo banke apo institucioni të cilët përgatisin apo përcjellin raporte në pajtim me këtë nen, raportin e tillë nuk ua sigurojnë as nuk raportojnë për ndonjë të dhënë të përfshirë në atë raport për asnjë person apo subjekt, duke përfshirë edhe personin apo subjektin e përfshirë në transaksionin i cili i nënshtrohet raportit, përpos Qendrës apo BPK-së, pa pasur autorizim me shkrim nga Qendra, prokurori publik ose gjykata.

3.13 Bankat dhe institucionet financiare i ruajnë të gjitha raportet dhe shënimet e përgatitura në pajtim me nenet 3.9 dhe 3.11 së paku pesë vite pas transaksionit për të cilin është përgatitur shënimi ose është dorëzuar raporti, varësisht se cila ndodh e fundit.

Pezullimi i transaksionit të dyshimtë

3.14 Banka ose institucioni financiar e njoftojnë Qendrën para ndërmarrjes së veprimeve lidhur me aktin ose transaksionin e dyshimtë, duke përfshirë edhe veprimin nga neni 3.7, që mund të rezultojë me lëshimin apo transferimin e pasurisë që i nënshtrohet transaksionit nga kontrolli i bankës apo i institucionit financiar. Njoftimi mund të bëhet gojarisht, por njoftimi i tillë nuk e anulon detyrën e dorëzimit të raportit të shkruar në pajtim me nenet 3.9 dhe 3.11.

3.15 Pas njoftimit në pajtim me nenin 3.14, Qendra mund të udhëzojë bankën apo institucionin financiar që të pezullojë ndërmarrjen e veprimit nga neni 3.14 lidhur me aktin ose transaksionin e dyshimtë për një kohë maksimale prej 48 orëve ose 2 ditë pune, varësisht se cila periudhë është më e gjatë. Pezullimi i veprimit në pajtim me këtë nen nuk i komunikohet asnjë personi ose subjekti, duke përfshirë edhe klientin, pa pëlqimin e Qendrës.

Programet e brendshme të bankës dhe të institucioneve financiare

3.16 Bankat dhe institucionet financiare do të caktojnë një kontakt-person i cili do të jetë përgjegjës për ndërveprim dhe këmbim informacionesh me BPK-në dhe Qendrën, i cili u nënshtrohet detyrimeve të raportimit dhe mbajtjes së shënimeve sipas kësaj Rregulloreje. Banka ose institucioni financiar e informon Departamentin Mbikëqyrës të Bankës dhe Qendrën për identitetin e kontakt-personit brenda 30 ditëve nga nxjerrja e kësaj Rregulloreje dhe pas kësaj informimin për çfarëdo ndryshimi të kontakt-personit të caktuar e bën brenda 30 ditëve.

3.17 Bankat dhe institucionet financiare do të nxjerrin procedura të brendshme të shkruara dhe do të vendosin kontroll për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe do t'i zbatojnë ato. Procedurat e tilla mes tjerash përfshijnë por nuk duhet të limitohen në:

- (a) Procedurën për identifikimin e klientit;
- (b) Procedurën për grumbullimin e të dhënave dhe ruajtjen e shënimeve në pajtim me këtë Rregullore dhe për parandalimin e qasjes së paautorizuar;
- (c) Procedurën e raportimit në Qendër në pajtim me nenet 3.9 deri në nenin 3.15;
- (d) Masat që duhet të ndërmerren nga banka apo institucioni financiar nga çasti i zbulimit të aktit ose transaksionit të dyshimtë deri në dorëzimin e raportit në Qendër në pajtim me nenet 3.9 deri në nenin 3.15;
- (e) Rregullat për përpunimin ose marrjen e veprimeve të mëtejme lidhur me aktin ose transaksionin e dyshuar, duke përfshirë masat për ndalimin e veprimeve të mëtejme

lidhur me aktin ose transaksionin e dyshuar pa e njoftuar Qendrën në pajtim me nenin 3.14;

(f) Procedurën për sigurimin e organizimit dhe financimit të programit për trajnimin e punëtorëve mbi përgjegjësitë e parapara në këtë nen dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe

(g) Funkcionin e revizorit për të testuar sistemin e raportimit dhe identifikimit.

3.18 Procedurat e parapara në nenin 3.17 bankat dhe institucionet financiare ia dorëzojnë Qendrës jo më vonë se 60 ditë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij neni ose 30 ditë pas themelimit të bankës ose institucionit financiar. Nëse procedurat e shkelin këtë Rregullore, Qendra e njofton bankën ose institucionin financiar për shkeljet. Banka ose institucioni financiar procedurat e ndryshuara i dorëzojnë brenda 30 ditëve.

Dënimet dhe masat

3.19 Sipas neneve 37 dhe 38 të Rregullores mbi veprimet bankare, çdo shkelje e këtij neni do të konsiderohet shkelje e Rregullores mbi veprimet bankare. Çdo dënim ose masë e shqiptuar në pajtim me nenet 37 dhe 38 të Rregullores mbi veprimet bankare do të jetë pa pasoja për çfarëdo procedure penale.

3.20 Çdo dënim ose masë e shqiptuar sipas nenet 3.19 do të jetë gjyqësisht i kontrollueshëm në pajtim me nenin 66 të Rregullores së BPK-së.

Data e hyrjes në fuqi

3.21 Ky nen hyn në fuqi më 1 maj 2004.

Neni 4 Detyrimet e OJQ-ve

4.1 Përpos asaj që është paraparë në nenin 4.3, OJQ-ja nuk do të pranojë kontribute në para që tejkalojnë 1.000 euro nga një burim i vetëm brenda një dite.

4.2 Përpos asaj që është paraparë në nenin 4.3, OJQ-ja nuk do t'i paguajë para që tejkalojnë 5.000 euro brenda një dite cilitdo marrësi të vetëm.

4.3 OJQ-të që kërkojnë përjashtim të njëhershëm ose të vazhdueshëm nga detyrimet e nenet 4.1 dhe 4.2, mund të dorëzojnë kërkesë me shkrim në Qendër për t'u përjashtuar, duke potencuar llojin e kërkuar të përjashtimit dhe arsyet për të. Kërkesës me shkrim Qendra i përgjigjet brenda 30 ditëve dhe mund të vendosë që ta lejojë, ta lejojë me kusht ose ta refuzojë përjashtimin. Vendimi i Qendrës është përfundimtar dhe nuk i nënshtrohet ankesës. Nëse Qendra vendos ta lejojë ose ta lejojë me kusht përjashtimin, një kopje të

vendimit të vet ia dorëzon Njësisë së UNMIK-ut për regjistrimin dhe ndërlidhjen e OJQ-ve ose agjencisë së saj pasardhëse.

4.4 OJQ-të do të ruajnë llogaritë të cilat dëshmojnë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet. Llogaritë do të identifikojnë të ardhurat sipas burimit, sasisë dhe mënyrës së pagesës, me para ose me urdhërpagesë, do të identifikojnë shpenzimet sipas marrësit, destinimin e shfrytëzimit të fondeve dhe mënyrën e pagesës. Dokumentet e llogarive do të ruhen pesë vite dhe do të jenë në dispozicion për inspektim me kërkesë të Qendrës dhe Njësisë së UNMIK-ut për regjistrimin dhe ndërlidhjen e OJQ-ve ose agjencisë së saj pasardhëse.

4.5 OJQ-të do t'i raportojnë Qendrës për akte apo transaksione të dyshimta brenda tri ditëve të punës dhe para ndërmarrjes së veprimeve të mëtejme lidhur me aktin apo transaksionin e tillë.

4.6 Me rastin e dorëzimit të raportit vjetor në pajtim me nenin 5 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2000/10, OJQ-ja në raport do të shpalosë:

(a) Çdo kontribut në para gjatë vitit nga një burim i caktuar, nëse vlera e përgjithshme në para e kontributeve nga ai burim gjatë vitit tejkalon 5.000 euro, duke identifikuar burimin, shumën dhe datën e çdo kontributi dhe

(b) Çdo pagesë në para gjatë vitit që i dedikohet marrësit të caktuar, nëse vlera e përgjithshme në para për pagesë dedikuar atij marrësi tejkalon 10.000 euro, duke identifikuar marrësin, shumën, datën e çdo pagese dhe destinimin e shfrytëzimit të parave.

4.7 Me rastin e dorëzimit të raportit vjetor në pajtim me nenin 5 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2000/1, OJQ-ja do të vërtetojë se i përmbush të gjitha detyrimet e këtij neni.

4.8 UNMIK-u mund të pezullojë ose të revokojë regjistrimin e një OJQ-je për shkelje të cilësdo dispozite të këtij neni në pajtim me nenin 5.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/22 mbi regjistrimin dhe veprimin e organizatave joqeveritare në Kosovë. Shqiptimi i sanksionit të tillë është pa pasoja për çfarëdo procedure penale.

4.9 Pavarësisht nga cilado dispozitë tjetër ligjore, raportet e dorëzuara nga OJQ-të në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/22 mbi regjistrimin dhe veprimin e organizatave joqeveritare në Kosovë dhe çfarëdo urdhërese administrative a rregulle të nxjerra në përputhje me të, Qendrës do t'i vihen në dispozicion me rastin e paraqitjes së kërkesës.

Data e hyrjes në fuqi

4.10 Ky nen hyn në fuqi më 1 korrik 2004.

Neni 5
Detyrimet e partive politike dhe kandidatëve të regjistruar

5.1 Partitë politike dhe kandidatët e regjistruar nuk do të pranojnë kontribute në para që tejkalojnë 1.000 euro nga një burim i vetëm brenda një dite.

5.2 Partitë politike dhe kandidatët e regjistruar nuk do t'i paguajnë një marrësi të vetëm para që tejkalojnë 5.000 euro brenda një dite.

5.3 Partitë politike do të ruajnë llogaritë të cilat shënojnë të ardhurat dhe shpenzimet. Llogaritë do të identifikojnë të ardhurat sipas burimit, shumës, mënyrës së pagesës, siç është pagesa me para apo me urdhërpagesë dhe pagesat sipas marrësit, destinimin e shfrytëzimit të fondeve si dhe mënyrën e pagesës. Dokumentet e llogaritjeve ruhen pesë vjet dhe do të jenë në dispozicion të Qendrës dhe Zyrës së regjistrimit të partisë politike për inspektim me rastin e paraqitjes së kërkesës.

5.4 Partitë politike do t'i raportojnë Qendrës për akte ose veprime bankare të dyshimta brenda tri ditëve të punës edhe para ndërmarrjes së veprimeve të mëtejme lidhur me aktin apo transaksionin e tillë.

5.5 Raportet vjetore të dorëzuara në pajtim me nenin 5 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/8 mbi ndryshimin e Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/16, mbi regjistrimin dhe veprimin e partive politike në Kosovë do të identifikojnë shumën dhe burimin e:

(a) Çdo kontributi në para nga një burim i caktuar gjatë vitit, nëse vlera e përgjithshme në para e kontributit nga ai burim gjatë vitit tejkalon 1.500 euro dhe

(b) Çdo pagesë në para dedikuar një burimi të caktuar gjatë vitit, nëse vlera e përgjithshme në para e pagesës dedikuar burimit të caktuar gjatë vitit tejkalon 10.000 euro duke identifikuar destinimin e shfrytëzimit.

5.6 Partia politike do të vërtetojë se i ka përmbushur të gjitha detyrimet nga ky nen në raportin e saj vjetor. Kandidati do të vërtetojë se i përmbush detyrimet nga nenet 5.1 dhe 5.2 në formularin e tij/saj të regjistrimit të kandidatëve dorëzuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

5.7 Zyra për regjistrimin e partive politike mund të hetojë përputhshmërinë e partisë politike me këtë nen dhe mund të pezullojë ose revokojë regjistrimin për shkelje të cilësdo dispozite të këtij neni në pajtim me nenin 5 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/8 mbi ndryshimin e Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/16, mbi regjistrimin dhe veprimin e partive politike në Kosovë. Sanksioni nga ky paragraf është pa pasoja për çfarëdo procedure penale.

5.8 Pavarësisht nga dispozitat tjera ligjore, raportet e dorëzuara nga partitë politike në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/8, mbi ndryshimin e Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut 2000/16, mbi regjistrimin dhe veprimin e partive politike në Kosovë do të vihen në dispozicion të Qendrës me rastin e paraqitjes së kërkesës.

Data e hyrjes në fuqi

5.9 Ky nen hyn në fuqi më 1 korrik 2004.

Neni 6

Detyrimet e avokatëve, kontabilistëve të certifikuar dhe revizorëve të licencuar

Identifikimi i klientëve

6.1 Avokatët, kontabilistët dhe revizorët e licencuar (më tutje “profesionistët në fjalë”) do të verifikojnë emrin dhe adresën dhe, në rastin e personave, datën e lindjes së çdo klienti para kryerjes së shërbimeve profesionale për klientin. Nenet 3.3 deri në nenin 3.7 do të zbatohen për verifikim dhe identifikim. Nëse profesionisti përkatës nuk mund ta identifikojë klientin ose ta verifikojë identitetin e tij/saj, ai apo ajo nuk do të pranojë pasuri nga klienti ose në emër të tij për asnjë qëllim.

Trajtimi i pasurisë së klientit

6.2 Kur profesionisti në cilëndo kohë posedon me pasuri në emër të klientit apo palës së tretë, profesionisti përkatës do të:

(a) Mbajë pasurinë në xhironlogari ose në ruajtje të bankës e cila i nënshtrohet mbikëqyrjes së BPK-së, përveç nëse klienti në mënyrë eksplicite pajtohet që pasuria të trajtohet ndryshe, ose kur lloji i pasurisë këtë nuk e lejon;

(b) Shënojë në titullin ose destinimin e xhironlogarisë se pasuria mbahet në emër të klientit ose klientëve të profesionistit në fjalë;

(c) Në rastin e parave të gatshme ose letrave me vlerë likuide do të ruajë një shumë në xhironlogari e cila në çdo kohë është baraz ose tejkalon shumën e pasurisë së klientit që mbahet nga profesionisti përkatës dhe

(d) Do të mbajë shënime të plota dhe të sakta, të cilat me rastin e kërkesës janë në dispozicion të klientit, duke treguar të gjitha qëndrimet me pasurinë e klientit dhe duke e veçuar pasurinë e klientit nga pasuritë tjera të cilat mbahen nga profesionisti përkatës.

Raportimi

6.3 Çdo profesionist në fjalë, i cili gjatë kryerjes së shërbimeve për klientin, pranon më shumë se 10.000 euro në para nga klienti për një transaksion ose transaksione të lidhura me të, do të dorëzojë raport në Qendër brenda 15 ditëve nga transaksioni i raportueshëm.

6.4 Sipas nenit 6.3, “transaksioni” përfshin mes tjerash: shitjen e mallrave dhe shërbimeve; shitjen e pasurisë së patundshme; shitjen e pasurisë jomateriale; qiradhënien e pasurisë së patundshme ose personale; këmbimin e parave për instrumente të tjera monetare, duke përfshirë edhe para të tjera; pagesën e një borxhi të mëparshëm; pagesën e shpenzimeve të paguara; vazhdimin ose ripagesën e huasë; pagesën e taksave në para profesionistit në fjalë për shërbimet e tij ose saj. Transaksioni gjithashtu do të raportohet nëse profesionisti përkatës i pranon paratë si ndërmjetësues, që do të thotë se ai ose ajo tenton të transferojë paratë tek pala e tretë në emër të klientit. Transaksioni nuk do të ndahet në transaksione të shumta për t’iu shmangur raportimit sipas këtij neni.

6.5 Sipas nenit 6.3, shprehja “transaksione të ndërlidhura” do të thotë të gjitha transaksionet e udhëhequra në mes të klientit dhe profesionistit në fjalë brenda një periudhe 24-orëshe ose të gjitha transaksionet e udhëhequra në mes të klientit dhe profesionistit në fjalë brenda një periudhe prej më shumë se 24-orëve, nëse marrësi është në dijeni ose ka arsye të jetë në dijeni se secili transaksion është njëri prej një sërë transaksionesh të ndërlidhura. Pagesat e shumta që i bëhen avokatit për përfaqësim në një rast të vetëm janë transaksione të ndërlidhura.

6.6 Forma dhe mënyra e raportimit do të rekomandohen nga Qendra dhe do të përfshijnë:

(a) Emrin dhe adresën, dhe të dhëna të tjera identifikuese të rekomanduara nga Qendra të personit apo subjektit nga i cili janë marrë paratë dhe çdo përfaqësuesi në emër të të cilit vepron personi apo subjekti;

(b) Shuma e parave të marra;

(c) Data dhe lloji i transaksionit dhe

(d) Informacione të tjera, duke përfshirë edhe identifikimin e personit a të subjektit që e ka dorëzuar raportin e rekomanduar nga Qendra.

6.7 Kontabilistët e certifikuar dhe revizorët e licencuar do t’i raportojnë Qendrës për çdo lloj akti apo transaksioni të dyshimtë brenda tri ditëve të punës dhe para ndërmarrjes së veprimeve të mëtejme lidhur me aktin apo transaksionin e tillë. Raportet do të përgatiten në formën dhe mënyrën e rekomanduar nga Qendra.

6.8 Përveç rasteve të parapara në nenin 6.9, avokatët e angazhuar në aktivitete specifike do t’i raportojnë Qendrës për akte apo transaksione të dyshimta brenda tri ditëve të punës dhe para ndërmarrjes së veprimeve të mëtejshme lidhur me aktin ose transaksionin e tillë. Në aktivitete specifike përfshihen:

- (a) Ndihma ose përfaqësimi i klientit apo klientëve në:
 - (i) Blerjen apo shitjen e pasurisë së paluajtshme ose të organizatave të biznesit;
 - (ii) Trajtimin e parave të klientit, letrave me vlerë ose pasurisë tjetër;
 - (iii) Hapjen ose menaxhimin e llogarive bankare, librezave të kursimit ose llogarive të letrave me vlerë;
 - (iv) Organizimin e kontributeve të nevojshme për krijimin, veprimin dhe menaxhimin e kompanive;
 - (v) Krijimin, veprimin ose menaxhimin e kompanive, trusteve ose strukturave të ngjashme dhe
- (b) Të vepruarit në emër të klientit ose për klientin në çfarëdo transaksioni financiar apo transaksion mbi të drejtat në pasurinë e paluajtshme.

Raportet do të përgatiten në formën dhe mënyrën e rekomanduar nga Qendra.

6.9 Avokati nuk do të jep informacione të cilat ai ose ajo i ka marrë nga klienti ose i ka mësuar për klientin për ta përfaqësuar klientin në procedurë penale a gjyqësore pa autorizim nga klienti ose me urdhër të gjykatës, përveç nëse avokati me arsye beson se klienti kërkon këshillën o ndihmën e avokatit për të kryer vepër penale.

6.10 Shënimet e grumbulluara në pajtim me nenin 6.1 do të ruhen për një periudhë pesëvjeçare nga dita e përfundimit të marrëdhënies afariste apo përfaqësimit. Shënimet relevante për aktin apo transaksionin e dyshimtë do të ruhen për një periudhë pesëvjeçare nga dita kur në Qendër është raportuar akti ose transaksioni i dyshimtë. Sa të jetë e mundur, shënimet e ruajtura në pajtim me këtë nen do të ruhen ndaras nga dosjet që përfshijnë të dhëna që i nënshtrohen të drejtës së posaçme avokat - klient.

6.11 Profesionistët në fjalë do të sigurojnë aftësimin e të gjithë anëtarëve të personelit, të punëtorëve dhe të përfaqësuesve me detyrimet nga kjo Rregullore.

6.12 Qendra, në konsultim me Shoqatën e Avokatëve të Kosovës dhe Bordin e Kosovës mbi standardet e raportimit financiar, do të caktojë standardet minimale, procedurat e shkruara dhe kontrollet për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave nga profesionistët në fjalë dhe do t'i mbikëqyrë ata. Këto procedura mes tjerash do të përfshijnë sa vijon:

- (a) Procedurën për identifikimin e klientit;

(b) Procedurën për grumbullimin e të dhënave dhe ruajtjen e shënimeve në pajtim me këtë Rregullore dhe për parandalimin e qasjes së paautorizuar;

(c) Procedurën e raportimit në Qendër në pajtim me nenet 6.3 deri në nenin 6.9;

(d) Një listë të detajuar për treguesit e aktit ose transaksionit të dyshimtë, duke marrë parasysh problemet specifike të krimit në Kosovë dhe sistemet ligjore dhe afariste të Kosovës;

(e) Masat që duhet ndërmarrë nga profesionistët përkatës nga momenti i zbulimit të aktit të dyshimtë ose të transaksionit deri te dorëzimi i raportit në Qendër;

(f) Procedurat për sigurimin e institucionit dhe sigurimi i një programi të aftësisë për punonjës të lidhur me obligimet sipas këtij neni, si dhe parandalimi i pastrimit të parave;

(g) Një funksion auditimi për të testuar raportimin dhe sistemin e identifikimit.

6.13 Shoqata e Avoketëve e Kosovës dhe Bordi i Standardeve i Kosovës për Raportimin Financiar duhet të informojë anëtarët e saj mbi procedurat e miratuara dhe obligimet e tyre si dhe për sanksionet e kësaj Rregulloreje në lidhje me profesionistët përkatës.

Sanksionet

6.14 Sanksioni i shqiptuar nga Shoqata e Avoketëve kompetent dhe nga Bordi i Standardeve i Kosovës për Raportim Financiar për shkelje të kësaj Rregulloreje nuk paragjykon asnjë nga procedurat penale.

Data e hyrjes në fuqi

6.15 Ky nen hyn në fuqi më 1 korrik 2004.

Neni 7

Obligimet e organizatës afariste

7.1 Ky nen vlen për të gjitha organizatat e biznesit, pos për bankat, institucionet financiare, avokatët, kontabilistët e certifikuar dhe auditorët e licencuar.

7.2 Secili person ose entitet, i cili është i angazhuar në një tregti ose biznes dhe i cili gjatë rrjedhës së asaj tregtie ose biznesi fiton më shumë se 10.000 euro para në ndonjë transaksion ose transaksione përkatëse duhet ta dorëzojë raportin në Qendër brenda 15 ditësh nga dita e transaksionit të raportuar.

7.3 Transaksionet përfshijnë, por nuk kufizohen si më poshtë: me shitjen e mallrave dhe të shërbimeve; me shitjen e pronës së paluajtshme; me shitjen e pronës së paprekshme; dhënien me qira ose pasurinë personale; këmbimin e parave të gatshme për mjete të tjera monetare (duke përfshirë edhe paratë e tjera); pagesën e borxheve paraekzistuese; kthimin e parave të shpenzimeve të paguara dhe krijimin ose kthyerjen e borxhit të kredisë. Transaksioni nuk mund të ndahet në transaksione të shumëfishta me qëllim të shmangies së raportimit nga ky nen.

7.4 Sipas këtij neni, shprehja “aksionet përkatëse” do të thotë të gjitha transaksionet e kryera midis paguesit (ose agjentit të tij) dhe marrësit të parave në një periudhë 24-orëshe ose të gjitha transaksionet e kryera midis paguesit (ose agjentit të tij) dhe marrësit të parave gjatë një periudhe prej më shumë se 24 orëve nëse marrësi e di ose ka arsye për të ditur se secili transaksion është njëri nga seria e transaksioneve të lidhura.

7.5 Forma dhe mënyra e raportimit duhet të përcaktohet nga Qendra.

Data e hyrjes në fuqi

7.6 Ky nen hyn në fuqi më 1 korrik 2004.

Neni 8

Transaksionet me pasurinë e paluajtshme

8.1 Kur transferi i të drejtave mbi pasurinë e paluajtshme përfshin një transaksion ose transaksione në një shumë të hollash që tejkalon 10.000 euro, secili transaksion duhet të bëhet me anë të urdhërpagesës ose transferit bankar.

8.1 Zyra Kadastrale Komunale (ZKK) nuk regjistron transferin e të drejtave mbi pasurinë e paluajtshme derisa nuk pranon një deklaratë krahas dokumenteve të tjera që paraqiten në pajtim me ligjin për regjistrimin e transferit në mënyrën dhe formën e saktësuar nga Qendra, të nënshkruar nga transferuesi dhe i transferuari i cili vërteton:

- (a) Regjistrimin e transferuesit dhe të të transferuarit;
- (b) Identitetin e secilit prej presonave ose entitetin që ka interes financiar dhe i cili është shfrytëzues i pronës që transferohet dhe natyrën e interesit a statusin e përfituesit;
- (c) Çmimin e blerjes dhe mënyrën e pagesës, nëse pagesa është pjesërisht ose tërësisht, duke përfshirë përmes transferit të pronës pos në të holla të gatshme një përshkrim dhe një vlerësim të vlerës së pronës;
- (d) Nëse transferi i nënshtrohet nenit 8.1, numri i llogarisë financiare ose numrat prej të cilëve pagesa ka qenë ose do të debitohet dhe te e cila ka qenë ose do të transferohet dhe emrat nën të cilët mbahen llogaritë.

8.3 ZKK mban deklaratën së bashku me dokumentet e tjerë që janë të dorëzuara në pajtim me ligjin mbi regjistrimin e transferit. Pos kësaj, ZKK i dërgon në Qendër kopjet e të gjitha deklaratave të pranuar në baza mujore.

8.4 Vendimi nga ana e ZKK për të refuzuar regjistrimin me arsyetimin e bazuar mbi mosrespektimin e këtij neni, do të bëhet si dhe mund të rishqyrtohet në pajtim me Ligjin nr. 2002/5 mbi themelimin e regjistrimit mbi të drejtat në pronën e paluajtshme, siç është shpallur me anë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/5 të datës 20 dhjetor të vitit 2002.

Data e hyrjes në fuqi

8.5 Ky nen hyn në fuqi më 1 korrik 2004.

Neni 9

Qarkullimi i mjeteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës

9.1 Secili person i cili hyn ose del nga Kosova dhe i cili bart mjete monetare në një vlerë që tejkalon 10.000 euro duhet të paraqesë me shkrim shumën e mjeteve monerate dhe burimin e tyre në një formë e cila duhet të përcaktohet nga drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Doganor të UNMIK-ut para nëpunësit të autorizuar të doganës dhe nëse kjo kërkohet nga nëpunësi, ai duhet të paraqesë mjetet e tilla monetare. Sipas këtij neni, konsiderohet se personi bart mjete financiare nëse, midis të tjerash, ato janë në posedim fizik të personit të tillë apo në automjetin privat ose në ndonjë mjet transporti tjetër që shfrytëzohet nga personi i tillë.

9.2 Secili person i cili nga Kosova dërgon në një vend jashtë Kosovës ose i cili i merr nga një vend tjetër dhe i dërgon në Kosovë mjete monetare, përmes postës ose zëdhënësit, komercial në një vlerë e cila tejkalon 10.000 euro duhet të deklarojë me shkrim shumën e mjeteve monetare dhe burimin e tyre në një formë e cila duhet të përcaktohet nga drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Doganor të UNMIK-ut para nëpunësit të autorizuar të doganës dhe, nëse këtë e kërkon nëpunësi, ai duhet t'i paraqesë mjetet monetare. Personi mund të plotësojë detyrën e tij lidhur me raportimin sipas këtij paragrafi me anë të njoftimit të përmbajtjes së pakos në deklaratën doganore ose në dokumentacionin ndërkombëtar të bagazhit.

9.3 Shërbimi Doganor i UNMIK-ut i dërgon në Qendër kopjet e të gjitha deklaratave të regjistruara në pajtim me nenet 9.1 dhe 9.2.

Procedura e kundërvajtjes

9.4 Personi, i cili nuk respekton dispozitat e neneve 9.1 ose 9.2, kryen veprë të kundërvajtjes që dënohen me gjobë në 25 % të shumës së mjeteve monetare të padeklaruara.

9.5 Nëpunësi i autorizuar i doganës i lëshon personit që ka kryer kundërvajtje sipas nenit 9.4 njoftimin me shkrim në një formular standard, ku deklarohet natyra e veprës kundërvajtëse dhe dënimi i shqiptuar i cili duhet të paguhet pa vonesë.

9.6 Nëse gjoba e shqiptuar nuk paguhet menjëherë, nëpunësi i autorizuar i doganës i konfiskon dhe i mban 25 % të asaj pjese të shumës së mjeteve monetare që tejkalon 10.000 euro. Nëse mjetet monetare nuk janë të ndashme në mënyrën që lejon konfiskimin dhe mbajtjen e shumës së saktë të mjeteve monetare të cilat duhet të konfiskohen dhe të mbahen, nëpunësi i autorizuar i doganës do të konfiskojë shumë më të madhe nga vlera, por sa të jetë e mundur ajo duhet të jetë më e afërtë me shumën e tillë.

9.7 Pas konfiskimit sipas nenit 9.6, nëpunësi i autorizuar i doganës i lëshon personit në fjalë vërtetimin me shkrim ku deklarohen faktet përkatëse, shuma e mjeteve monetare të konfiskuara dhe të mbajtura.

9.8 Mjetet monetare të konfiskuara dhe të ruajtura në pajtim me këtë nen, nëse është e mundur do të ruhen në një llogari të posaçme pa kamatë në BPK në emër të UNMIK-ut ose lihen në ruajtje të sigurt në BPK për aq kohë derisa të paguhet gjoba e plotë apo siç është urdhëruar nga gjykata kompetente, përkatësisht në mënyrën e paraparë me këtë nen.

9.9 Nëse personi mjetet monetare të të cilit janë konfiskuar në pajtim me nenin 9.6 paguan gjobën brenda 30 ditësh nga dita e konfiskimit, që fillimisht është dashur ta paguajë, autoriteti kompetent duhet të marrë masa për kthimin e mjeteve të konfiskuara monetare ose vlerën e tyre ekuivalente sipas nevojës pos nëse ekzistojnë baza ligjore ose për konfiskim të mjeteve monetare apo për shumën e barabartë ose për të vazhduar për t'i mbajtur ato nga personi prej të cilit janë konfiskuar mjetet monetare. Masat e tilla duhet të ndërmerren brenda 5 ditësh nga data e pranimit të pagesës së gjobës.

9.10 Nëse personi i cili paguan gjobën brenda një periudhe prej 30 ditësh në pajtim me nenin 9.9 nuk është në gjendje për të marrë personalisht mjetet e konfiskuara monetare, ai mund:

(a) T'ia përcjellë autorizimin e avokatit një personi tjetër të cilin e autorizon për t'i marrë mjetet e konfiskuara monetare në emër të tij ose duhet t'i sigurojë autoritetit kompetent dokumentin e nënshkruar me shkrim ose të noterizuar me të cilin udhëzohet personi i tillë për t'i kthyer mjetet monetare te personi tjetër i emërtuar ose

(b) Të dorëzojë kërkesën me shkrim të adresuar në BPK për të deponuar mjetet monetare në një llogari speciale të UNMIK-ut në emër të personit të tillë deri në kohën kur mjetet monetare të merren personalisht nga personi në fjalë ose nga personi i autorizuar për ta bërë këtë në përputhje me nenin 9.10(a).

9.11 Nëse gjoba është paguar në tërësi brenda periudhës 30-ditëshe të saktësuar në nenin 9.9, por mjetet monetare të konfiskuara nuk janë marrë brenda 12 muajsh nga

data e konfiskimit, mjetet e tilla monetare duhet t'i merren UNMIK -ut dhe të depozitohen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

9.12 Nëse personi nuk e paguan gjobën e shqiptuar në përputhje me nenin 9.4 brenda 30 ditësh, çështja do t'i dërgohet gjykatës kompetente për kundërvajtje për të vendosur në pajtim me procedurën e parashtruar në nenin 9.14.

9.13 Personi ndaj të cilit është shqiptuar gjobë sipas nenit 9.4 apo instrumentet monetare të të cilit janë konfiskuar në pajtim me nenin 9.6, mund të kontestojë shqiptimin e gjobës ose konfiskimin në gjykatën kompetente për kundërvajtje brenda 30 ditësh nga data e nxjerrjes së njoftimit me shkrim mbi shqiptimin e gjobës së tillë ose vërtetimin me shkrim që konfirmon konfiskimin e tillë.

9.14 Gjykata kompetente për kundërvajtje, e cila trajton rastin në pajtim me nenet 9.12 ose 9.13, mund:

(a) Të konfirmojë gjobën ose konfiskimin. Bilanci i saj duhet t'i merret UNMIK -ut dhe të depozitohet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës ose

(b) Të lë anash apo të reduktojë shumën e gjobës ose të lë anash konfiskimin apo të reduktojë shumën e mjeteve monetare të konfiskuara, nëse gjykata vendos se gjoba është vlerësuar apo se konfiskimi nuk është kryer në përputhje me këtë nen si shkelje e ligjit në fuqi. Mjetet monetare me vlerë duhet të mbahen deri në gjashtë muaj nga data e urdhëresës së gjykatës, nëse personi në fjalë nuk paraqitet në gjykatë ose nuk i merr ato. Pas kalimit të këtij afati të caktuar gjashtëmuajor, nëse për mjetet monetare në fjalë nuk është shtruar ankesa nga personi në fjalë dhe nuk është vendosur ose lëshuar urdhër nga gjykata kompetente për kundërvajtje, mjetet monetare me vlerë duhet t'i dorëzohen UNMIK -ut dhe të depozitohen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

9.15 Gjopa, konfiskimi ose mbajtja e kryer në përputhje me nenet 9.4 deri në nenin 9.14 është pa pasoja për cilëndo procedurë penale ndaj personit, konfiskimit të përkohshëm të instrumenteve monetare në përputhje me nenin 9.17, konfiskimit në përputhje me nenin 11 ose masave të përkohshme për sigurimin e pasurisë në përputhje me nenin 12.

9.16 Gjopa e shqiptuar në pajtim me nenin 9.4 ose konfiskimi apo mbajtja e mjeteve monetare në pajtim me nenin 9.6 është valide dhe mbetet në fuqi pavarësisht nga kontestimi i gjobës së tillë, konfiskimit apo mbajtjes në pritje të zgjidhjes së kontestimit.

Konfiskimi i përkohshëm i mjeteve monetare

9.17 Nëpunësi i doganës apo zyrtari i policisë mund të konfiskojnë mjetet monetare të bartura nga personi i cili hyn apo del nga Kosova nëse ekziston dyshimi i bazuar se mjetet e tilla monetare janë pasuri e fituar me vepër penale, janë përdorur apo është tentuar që të përdoren për të kryer ose për të lehtësuar pastrimin e parave apo për të kryer veprën e pohuar penale nga e cila buron pasuria e fituar me vepër penale. Nëpunësi i tillë

doganor ose zyrtari i policisë e njofton prokurorin kompetent publik të qarkut brenda 48 orësh nga koha e konfiskimit. Brenda 10 ditësh nga njoftimi i tillë, prokurori publik i qarkut duhet:

- (a) Të dorëzojë propozimin për konfiskim të pronës në pajtim me nenin 11;
- (b) Të dorëzojë propozimin për masa të përkohshme për sigurim të pasurisë në pajtim me nenin 12.1 ose
- (c) Të njoftojë me shkrim autoritetin kompetent se kurrfarë aksioni nuk duhet të ndërmerret në lidhje me pasurinë e konfiskuar.

Nëse prokurori publik i qarkut njofton me shkrim se kurrfarë aksioni nuk duhet të ndërmerret në lidhje me pasurinë e konfiskuar, autoriteti kompetent duhet t'ia kthejë mjetet monetare personit prej të cilit ato janë marrë brenda pesë ditëve të punës.

9.18 Nëpunësit doganorë dhe zyrtarët e policisë nuk janë personalisht përgjegjës ose nuk konsiderohen përgjegjës për dëmet ose humbjen që rezultojn nga veprimet në mirëbesim ose mungesat gjatë rrjedhës së ushtrimit të detyrave të tyre zyrtare sipas këtij neni.

Neni 10

Veprat penale

10.1 Gjykatat e qarkut kanë juridiksion të plotë për të gjitha veprat penale sipas këtij neni.

Pastrimi i parave

10.2 Kushdo që, duke e ditur ose që ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me vepër penale ose kushdo që, duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 200/6 të datës 16 mars 2002 mbi masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe të hetimit:

- (a) Konverton a transferon ose përpiqet të konvertojë a të transferojë pasurinë me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë;
- (b) Konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë a të transferojë pasurinë me qëllim të ndihmës së personit i cili është i përfshirë në të ose që, siç pandehet, është i përfshirë në kryerjen e veprës penale që ka shkaktuar shmangien e pasojave ligjore a të pasojave të qarta ligjore të veprimeve të tij;

(c) Konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë a transferojë pasurinë me qëllim të shmangies së obligimit të raportimit sipas kësaj Rregulloreje;

(d) Konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë a transferojë pasurinë me qëllim të nxitjes së aktivitetit të ndërlidhur kriminal dhe

(e) Merr, posedon ose shfrytëzon apo përpiqet të marrë, të posedojë ose të shfrytëzojë pasurinë,

kryen veprë penale të dënueshme me një afat burgosjeje deri në dhjetë vjet dhe me gjobë deri në tri herë më të madhe në vlerë të pasurisë e cila i shtrohet veprës penale.

10.3 Sipas nenit 10.2 përfaqësimet mund të jenë bazë për të besuar se pasuria e caktuar përbën pasuri të fituar me anë të veprës penale, madje edhe nëse ato përfaqësimet vetëm tërthorazi mbështesin besimin se ajo përbën pasuri të fituar me anë të veprës penale.

10.4 Pa cenuar ligjin penal në fuqi lidhur me personin i cili ka kryer veprat e ndërlidhura penale jashtë fushëveprimit të këtij paragrafi:

(a) Personi mund të dënohet për veprë penale të pastrimit të parave madje edhe nëse nuk ka qenë i dënuar asnjëherë për veprë të ndërlidhur penale prej të cilës është nxjerrë pasuria e fituar me anë të veprës penale;

(b) I njëjti person mund të ndiqet dhe të dënohet në procedura të veçanta të veprave penale të pastrimit të parave dhe të veprës së ndërlidhur penale prej të cilës është nxjerrë pasuria e fituar me anë të veprës penale dhe

(c) Gjykatat e Kosovës mund të kenë juridiksion mbi veprën penale të pastrimit të parave, madje edhe nëse ato nuk kanë juridiksion territorial mbi veprat e ndërlidhura penale prej të cilave është nxjerrë pasuria e fituar me anë të veprës penale të pastrimit të parave, ngaqë ka qenë kryer jashtë Kosovës.

Veprat e tjera penale

10.5 Kushdo që duke siguruar ndonjë informacion apo duke raportuar dhe duke bërë certifikata ose deklarime në pajtim me nenet prej 3.1 deri 3.5, prej 3.9 deri në 3.11, prej 4.3 deri në 4.7, prej 5.3 deri në 5.6, 6.1, 6.3, 6.7, 6.8, 7.2, 8.2, 9.1 ose 9.2 të kësaj Rregulloreje, me dije:

(a) Bën çfarëdo deklarate materiale të rrejshme ose me qëllim nuk i zbulon informacion material ose

(b) Bën apo shfrytëzon çfarëdo dokumenti duke e ditur se dokumenti përmban deklaratë ose shënime të rrejshme materiale, mostregim material ose gabim material

kryen veprë penale të dënueshme me burgim deri në pesë vjet dhe me gjobë deri në 100.000 euro.

10.6 Kushdo që me dashje:

(a) Shkatërro ose largon çfarëdo shënimesh që duhet të mbahen në pajtim me nenet 3.8, 3.13, 4.4, 5.3, 6.10 a 8.3 ose

(b) Nuk raporton në pajtim me nenet 3.9, 3.11, 4.5, 5.4, 6.3, 6.7, 6.8 apo 7.2,

kryen veprë penale të dënueshme me burgim deri në dy vjet dhe me gjobë deri në 100.000 euro. Nëse çfarëdo veprë penale e paraparë me këtë paragraf kryhet me qëllim të pengimit të rolit rregullues ose të zbatimit të ligjit, kryerësi dënohet me burgim deri në pesë vjet dhe me gjobë deri në 100.000 euro.

10.7 Personi i cili vepron në cilësi të bankës, të institucionit financiar ose të nëpunësit, drejtorit, agjentit ose punonjësi i bankës apo i institucionit financiar i cili me dashje shkel nenin 3.12 të kësaj Rregulloreje, kryen veprë penale të dënueshme me burgim deri në dy vjet ose me gjobë deri në 100.000 euro. Nëse ndonjëra prej veprave penale të saktësuara në këtë paragraf kryhet me qëllim të pengimit të rolit rregullues ose të zbatimit të ligjit, kryerësi dënohet me burgim deri në pesë vjet dhe(ose) me gjobë deri në 100.000 euro.

10.8 Kushdo që me dashje pranon ose paguan valutën në kundërshtim me nenet 4.1, 4.2, 5.1 ose 5.2 të kësaj Rregulloreje, kryen veprë penale të dënueshme me burgim deri në dy vjet dhe me gjobë deri në 5.000 euro ose me dyfishin e shumës së valutës së pranuar a të paguar, cilado prej tyre që është më e lartë.

10.9 Nëpunësi i Qendrës i cili me dashje:

(a) Raporton informacionin ose zbulon informacionin në pajtim me neni 2.3 ose i cili ia zbulon informacionin prokurorit publik a gjykatës, duke e ditur se informacioni i tillë përmban material të rrejshëm, pasaktësi materiale ose gabim material;

(b) Shkatërro ose largon çfarëdo të dhënash të cilat duhet të mblidhen nga Qendra në pajtim me këtë Rregullore, ndryshe nga ç'është paraparë me politikën e mbajtjes dhe të shkatërrimit të dokumenteve të krijuar nga Qendra ose

(c) Zbulon çfarëdo informacioni të përshkruar në nenin 2.2 ndryshe nga ç'është paraparë me nenin 2.3, pos nëse është i autorizuar me shkrim nga zëvendësi i Përfaqësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm për Polici dhe Drejtësi; kryen veprë penale të dënueshme me burgim deri në dy vite dhe me gjobë deri në 100.000 euro. Nëse vepra penale e parashtruar në këtë paragraf kryhet me qëllim të pengimit të rolit rregullues ose

të zbatimit të ligjit, kryerësi dënohet me burgim deri në dhjetë vjet dhe me gjobë deri në 100.000 euro.

10.10 Në nenet 10.5 dhe 10.9, informacioni ose mungesa e sigurimit të informacionit mund të jetë materiale nëse pranuesi nuk është ndikuar apo çorientuar nga ai.

10.11 Kushdo që vepron në cilësinë e bankës ose të institucionit financiar sipas përkufizimit në këtë Rregullore pa regjistrim në pajtim me nenin 3.1 të Rregullores mbi Bankat kryen veprë penale të dënueshme me burgim deri në një vit ose me gjobë deri në 100.000 euro.

10.12 Kushdo që kundërligjshëm refuzon ose pengon inspektimin e ndërmarrë ligjërisht në pajtim me nenin 2.4 ose 2.5 ose me dashje fshef shënimet që duhet të mbahen dhe të paraqiten në pajtim me këtë Rregullore, kryen veprë penale të dënueshme me burgim deri në një vit dhe me gjobë deri në 100.000 euro.

10.13 Kushdo që me dashje shkel rregullën me të cilën urdhërohet masa e përkohshme për sigurimin e pasurisë sipas nenit 12, kryen veprë penale të dënueshme me burgim deri në pesë vjet dhe me gjobë deri në 100.000 euro.

10.14 Sipas nenit 10.5 deri te 10.9, 10.12 dhe 10.13, akt “me dashje” konsiderohet akti i cili kryhet jo vetëm qëllimisht, por edhe me dashje që nuk kryhet paqëllim nga pakujdesia ose rastësisht.

Përgjegjësia penale e personave juridikë

10.15 Përgjegjësia penale e personave juridikë për veprat penale të parapara në këtë nen do të parashtrohet në një Rregullore e cila do të shpallet brenda gjashtë muajsh nga data e nënshkrimit të kësaj Rregulloreje.

Neni 11 Konfiskimi

11.1 Prokurori publik mund të dorëzojë propozimin për konfiskim të pasurisë që rrjedh nga krimi ose është përdorur apo ka pasur për qëllim të përdoret për të kryer a për të lehtësuar pastrimin e parave ose veprën e ndërlidhur penale prej të cilës është nxjerr pasuria e fituar me anë të veprës penale. Propozimi i tillë mund të dorëzohet pavarësisht nëse procedura penale është filluar kundër një personi në lidhje me pasurinë dhe pa pasoja për fillimin e procedurës së tillë penale. Ai duhet të dorëzohet:

(a) Në rast të fillimit të procedurës penale për veprën penale të pastrimit të parave sipas nenit 10.2 në gjykatën e qarkut në të cilën procedura penale ka qenë zhvilluar dhe

(b) Në të gjitha rrethanat e tjera, në gjykatën e qarkut brenda territorit të së cilës pasuria ose një pjesë e pasurisë ndodhet, pos nëse pasuria ndodhet jashtë Kosovës në ç'rast propozimi duhet të dorëzohet në cilëndo gjykatë të qarkut në Kosovë.

11.2 Propozimi i dorëzuar sipas nenit 11.1 duhet të përfshijë si më poshtë:

(a) Përshkrimin e hollësishëm të natyrës dhe të vendit të pasurisë për të cilën është kërkuar konfiskimi;

(b) Identifikimin e hollësive të të gjithë personave ose entiteteve për të cilët prokurori publik ka arsye për të besuar se mund të posedojnë ose përfitojnë nga pasuria dhe

(c) Deklaratën mbi bazën e të cilës bëhet konfiskimi i pasurisë.

Nëse propozimi sipas nenit 11.1 nuk është dorëzuar pas dënimit për pastrimin e parave sipas nenit 10.2, propozimi po ashtu duhet të përmbajë deklaratën e veprimit të ndërmarrë për identifikimin e personave ose entiteteve që mund të posedojnë apo të jenë shfrytëzues të pasurisë.

Njoftimi

11.3 Me rastin e pranimit të propozimit për konfiskim sipas nenit 11.1, gjykata lëshon:

(a) Njoftimin i cili brenda tridhjetë ditësh duhet të dërgohet në gjykatë me postë;

(b) Njoftimin i cili duhet të dërgohet me postë për dhjetë ditë në një gazetë të qarkullimit masiv në gjuhën shqipe dhe serbe në territorin e gjykatës, po nëse aty nuk ekziston ndonjë gazetë e tillë, duhet të njoftohet me anë të radios në programet në gjuhën shqipe dhe serbe dhjetë ditë rresht dhe

(c) Njoftimin i cili në pajtim me dispozitat e ligjit në fuqi mbi procedurën penale duhet t'u jepet të gjithë personave dhe entiteteve të cilët gjykata ka arsye për të besuar se mund të posedojnë ose mund të jenë shfrytëzues të pasurisë, pos nëse është e përealizueshme për t'u kryer dhënia e tillë personalisht.

Secilili njoftim duhet të saktësojë:

(a) Natyrën dhe vendin e pasurisë, që i nënshtrohet propozimit, e në rast se pasuria e cila i nënshtrohet masave të përkohshme për sigurimin e pronës sipas nenit 12 edhe vendi prej të cilit është konfiskuar dhe

(b) Procedurën për paraqitjen e ankesës me të cilën kërkohet pasuria.

Ankesat me anë të të cilave kërkohet pronësia ose statusi i benificiar

11.4 Personi ose entiteti mund të parashtrijë ankesën në gjykatë me anë të të cilës pohohet se personi ose entiteti është pronar a shfrytëzues i pasurisë e cila i nënshtrohet propozimit për konfiskim brenda 30 ditësh më së voni nga lëshimi i njoftimeve sipas nenit 11.3. Ankesa duhet të identifikojë:

- (a) Pasurinë e cila i nënshtrohet kërkesës;
- (b) Sasinë dhe natyrën e pronësisë ose të statusit të benificiar lidhur me pasurinë e cila kërkohet;
- (c) Datën dhe rrethanat në të cilat është marrë pronësia ose statusi i benificiar lidhur me pasurinë;
- (d) Bazat ligjore për kërkesën dhe
- (e) Çfarëdo dëshmie përkatëse lidhur me kërkesën.

Aktvendimet lidhur me konfiskimin e pasurisë

11.5 Pas kalimit të periudhës 30-ditëshe të paraparë me nenin 11.4, gjykata vendos nëse pasuria, e cila i është nënshtuar propozimit të prokurorit publik është fituar me anë të veprës penale ose është shfrytëzuar a ka pasur për qëllim të shfrytëzohet për të kryer pastrimin e parave ose është vepër e ndërlidhur penale prej të cilës është nxjerrë pasuria e fituar me anë të veprës penale. Nëse një ose më shumë ankesa janë paraqitur në pajtim me nenin 11.4, gjykata do të mbajë séanceë në të cilën pala ankuese ose palët ankuese dhe prokurori publik do të dëgjohen dhe mund të paraqesin dëshmitë.

11.6 Nëse gjykata konstaton se pasuria është fituar me anë të veprës penale, atëherë gjykata lëshon vendimin me të cilin pasuria duhet të konfiskohet, pos nëse:

- (a) Pala ankuese është blerëse *bona fide* për vlerën e pasurisë dhe
- (b) Pala ankuese nuk e ka ditur dhe me arsye nuk ka mundur ta dijë se ajo pasuri është fituar me anë të veprës penale.

11.7 Nëse gjykata konstaton se pasuria është përdorur ose ka pasur për qëllim të përdoret për të kryer ose për të lehtësuar pastrimin e parave apo të veprës së ndërlidhur penale prej të cilës është nxjerrë pasuria e fituar me anë të veprës penale, gjykata sjell vendimin sipas të cilit pasuria duhet të konfiskohet, pos nëse:

- (a) Pala ankuese është pronari i vërtetë i pasurisë;
- (b) Pala ankuese nuk e ka ditur dhe me arsye nuk ka mundur ta dijë se pasuria është përdorur ose ka pasur për qëllim të përdoret për të kryer a për të lehtësuar pastrimin

e parasë ose veprën e ndërlidhur penale prej të cilës është nxjerrë pasuria e fituar me anë të veprës penale dhe

(c) Pasi ka mësuar se pasuria është përdorur ose ka pasur për qëllim të përdoret për të kryer ose për të lehtësuar pastrimin e parave ose veprën e ndërlidhur penale prej të cilës është nxjerrë pasuria e fituar me anë të veprës penale, pala ankuese ka bërë gjithçka që në mënyrë të arsyeshme mund të pritej prej tij për të ndërprerë përdorimin e tillë të pasurisë.

11.8 Në rast të propozimit për konfiskim pas dënimit sipas nenit 10.2, nëse gjykata konstaton se pasuria, e cila i nënshtrohet propozimit është fituar me anë të veprës penale, ose është përdorur apo ka pasur për qëllim të përdoret për të kryer a për të lehtësuar pastrimin e parave ose veprën e ndërlidhur penale prej të cilës është nxjerrë pasuria e fituar me anë të veprës penale, por pasuria e tillë:

(a) Nuk mund të vendoset me anë të përpjekjeve të arsyeshme ose

(b) Si rezultat i një veprimi a mosveprimi nga ana e kryerësit, pasuria ka qenë transferuar ose ka qenë shitur te pala e tretë, është fshehur, është shpenzuar, është shkatërruar ose është zvogëluar në vlerë, është vendosur përtej juridiksionit të gjykatës ose është përzier me pasuri tjetër e cila nuk mund të ndahet pa vështirësi,

gjykata lëshon aktvendimin se pasuria e poseduar nga kryerësi që është e një vlere të barabartë me pasurinë i nënshtrohet propozimit për t'u konfiskuar.

Dispozicioni i pasurisë së konfiskuar

11.9 Pasuria e cila duhet të konfiskohet sipas aktvendimit të lëshuar me këtë nen duhet të vihet në dispozicion për ekzekutim të vendimit në favor të palës së dëmtuar në pajtim me kapitullin X të Ligjit në Fuqi mbi Procedurën Penale nëse nuk ka pasuri tjetër, e cila i takon kryerësit për realizimin e ankesës pronësore të palës së dëmtuar. Gjykata urdhëron që çfarëdo pasurie tjetër e mbetur të shitet në pajtim me procedurat që duhet të përcaktohen në përputhje me një Urdhëresë Administrative.

Neni 12

Masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë

12.1 Pas propozimit me shkrim nga ana e prokurorit publik, gjykata e qarkut lëshon aktvendimin me të cilin urdhërohet masa e përkohshme për sigurimin e pasurisë atëherë kur:

(a) Ekziston dyshimi i bazuar se pasuria është fituar me anë të veprës penale ose është përdorur apo ka pasur për qëllim të përdoret për të kryer a për të lehtësuar pastrimin e parave ose veprën e ndërlidhur penale prej të cilës është nxjerrë pasuria e fituar me anë të veprës penale dhe

(b) Ekziston gjasa thelbore se pasuria nuk do të jetë në dispozicion për konfiskim në përfundim të procedurës sipas nenit 11 nëse masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë nuk ndërmerren.

12.2 Nëse prokurori publik dorëzon propozimin sipas nenit 12.1 gjatë procedurës penale, gjykatësi hetues ka kompetencë para se të jetë ngritur padia, ndërsa këtë kompetencë më vonë e ushtron kryetari i trupit gjykues. Nëse nuk është duke u zhvilluar procedura penale në lidhje me pasurinë e cila i nënshtrohet propozimit, kompetencë ka gjykatësi hetues i gjykatës së qarkut brenda territorit të së cilës ndodhet pasuria ose një pjesë e asaj pasurie.

12.3 Propozimi i prokurorit publik duhet të përmbajë si më poshtë:

(a) Përshkrimin e hollësishëm të natyrës dhe të vendit të pasurisë që i nënshtrohet propozimit;

(b) Identifikimin e hollësive mbi personat ose entitetet që janë në posedim të pasurisë dhe

(c) Deklaratën lidhur me arsyetimin për masat e përkohshme të sigurimit të pasurisë.

12.4 Aktvendimi me të cilin urdhërohen masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë duhet të bëhet me shkrim dhe të urdhërohet një apo më shumë nga masat e mëposhtme brenda një periudhe deri në 30 ditë:

(a) Se asnjë person ose entitet nuk mund të shesë, të transferojë, të fshehë, të shkatërrojë ose të merret në mënyra të tjera me pasurinë;

(b) Se asnjë bankë ose institucion financiar nuk mund të transferojë pasurinë, të kryejë transaksione lidhur me pasurinë ose t'i lejojë qasje në pasuri nëse ajo mbahet në bankë ose në institucionin financiar;

(c) Se në rast të pronës së patundshme autoritetet kompetente do të refuzojnë të verifikojnë kontratën e shitjes ose të regjistrojnë transferin e pasurisë;

(d) Se në rast të pasurisë së patundshme policia ose nëpunësit e doganës do të dërgojnë njoftimin mbi pasurinë me të cilin deklarohet se pasuria i nënshtrohet aktvendimit sipas këtij neni dhe se nuk mund të transferohet ose fshihet;

(e) Se në rast të pasurisë së patundshme ose të një organizate afaristetë gjitha qiratë ose të hyrat e tjera nga pasuria duhet të paguhen nën përkujdesjen e policisë ose të shërbimit doganor, i cili do të mirret me pasurinë e tillë siç parashihet në nenin 12.9;

(f) Se një Administrator i besuar do të caktohet nga gjykata për të marrë kontrollin dhe për të menaxhuar me pasurinë nëse pasuria e tillë mund të krijojë të hyra, përkatësisht nëse kërkon menaxhim;

(g) Se në rast të pasurisë së patundshme, nëpunësit e autorizuar të doganës ose zyrtarët e autorizuar të policisë do të konfiskojnë pasurinë dhe do ta mbajnë atë në pajtim me nenet 12.9 dhe 12.10 ose ashtu siç është urdhëruar nga gjykata dhe

(h) Se disa masa të tjera do të mirren për sigurimin e përkohshëm të pasurisë.

12.5 Pas propozimit me shkrim të prokurorit publik, vendimi me të cilin urdhërohen masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë mund të shtyhet me vendime të mëtejme për periudhat deri në 30 ditë nëse vazhdojnë të vlejnjë kushtet e parashtruara në nenin 12.1.

12.6 Pas propozimit me shkrim të prokurorit publik, gjykata mund të vendosë që propozimi dhe aktvendimi nga neni 12.4 mos të zbulohet për një periudhë kohe që i tejkalon 30 ditë për personat ose entitetet tjera pos atyre që janë saktësuar me emër, përkatësisht që janë identifikuar në aktvendim nëse ekziston dyshimi i bazuar se pasuria mund të fshihet, të transferohet ose të mos vihet në dispozicion nëse propozimi dhe aktvendimi janë bërë të ditura. Nëse aktvendimi sipas nenit 12.4 shtyhet për një periudhë tjetër deri në 30 ditë, gjykata, pas propozimit tjetër me shkrim nga prokurori publik, mund të vendosë ta shtyjë periudhën e moszbulimit sipas këtij paragrafi për një periudhë e cila nuk i tejkalon 30 ditë për shkaqe të arsyeshme.

Ekzekutimi i aktvendimit

12.7 Nëse urdhërohet ndryshe në pajtim me nenin 12.6, kopjet e aktvendimit të lëshuar sipas nenit 12.4 ose 12.5 duhet të dorëzohen personalisht brenda 10 ditësh nga data në të cilën është lëshuar aktvendimi, duhet dorëzuar personalisht në pajtim me ligjin në fuqi mbi procedurën penale secilit prej personave dhe entiteteve të mëposhtme, pos nëse kjo është e përcaktueshme për të kryer shërbimet e tilla personale:

(a) Secili person ose entitet për të cilin gjykata ka arsye për të besuar se është pronar ose shfrytëzues i pasurisë së bashku me një specifikim të procedurës për kërkimin e ndërprerjes së aktvendimit;

(b) Secili person ose entitet i cili duhet të jetë i obliguar sipas aktvendimit për të ndërmarrë veprime për të zbatuar atë dhe

(c) Secili person ose entitet tjetër i cili është i obliguar sipas aktvendimit për të mos ndërmarrë ndonjë veprim të caktuar lidhur me pasurinë, nëse gjykata konsideron se dërgimi personal i aktvendimit do të rrisë gjasën se ai person ose entitet nuk do të ndërmarrë veprimin në fjalë.

12.8 Aktvendimi me të cilin urdhërohet masa e përkohshme për sigurimin e pasurisë së paluajtshme në pajtim me nenin 12.4(g) duhet të ekzekutohet brenda 10 ditësh nga

data e lëshimit të aktvendimit, pos nëse gjykata urdhëron me aktvendim që periudha e tillë e kohës të shtyhet. Nëpunësit e autorizuar të cilët ekzekutojnë aktvendimin sipas nenit 12.4(g) duhet t'i sigurojnë gjykatës një inventarizim të të gjithë pasurisë e cila i nënshtrohet aktvendimit brenda tri ditëve të punës.

Mirëmbajtja dhe disponimi i pasurisë

12.9

Pasuria e cila i nënshtrohet aktvendimit në pajtim me këtë nen do të mbahet nga nëpunësit e doganës ose zyrtarët e policisë, nëse nuk është urdhëruar ndryshe nga gjykata. Nëpunësit e tillë të doganës ose zyrtarët e policisë duhet të sigurojnë dëshminë kur është dërguar pasuria dhe duhet të mirëmbajnë ose disponojnë me pasurinë në pajtim me procedurat e caktuara në përputhje me një urdhëresë administrative. Gjykata në çdo kohë mund të kërkojë që nëpunësit e doganës ose zyrtarët e policisë të sigurojnë një llogari mbi pasurinë.

12.10 Me propozimin e prokurorit publik, nëpunësit të doganës ose zyrtarët të policisë gjykata mund të lëshojë aktvendimin me të cilin autorizohet shitja e pasurisë, përfitimet prej të cilës do të mbahen në pajtim me procedurat e përcaktuara me një urdhëresë administrative. Kur vendoset mbi aktvendimin e tillë, gjykata mund të merr parasysh nëse pasuria mund të zhduket a priset ose në ndonjë mënyrë të zbrësë nga vlera, nëse shpenzimet e mirëmbajtjes së pasurisë janë në shpërputhje me vlerën e saj dhe nëse personat ose entitetet të cilët posedojnë ose janë shfrytëzues të pasurisë pajtohen për ta shitur atë.

Procedurat për palët ankuese

12.11 Me paraqitjen e ankesës nga prokurori publik, personi apo entitetit i cili posedon ose është shfrytëzues i pasurisë e cila i nënshtrohet aktvendimit sipas këtij neni, gjykata do të ndërpresë aktvendimin kur kushtet e parashtruara në nenin 12.1 nuk ekzistojnë më. Pos kësaj, gjykata mund të modifikojë aktvendimin nëse masat e përkohshme të sigurimit të pasurisë i krijojnë vështirësi të paarsyeshme palës ankuese, me kusht që modifikimet e tilla të mos e reduktojnë gjasën se pasuria do të jetë në dispozicion për konfiskim në përfundim të procedurës sipas nenit 11.

12.12 Nëse gjatë procedurës penale para akuzës lidhur me pasurinë e cila i nënshtrohet masave të përkohshme sipas këtij neni nuk është parashtruar padi brenda 90 ditësh të aktvendimit të parë me të cilin urdhërohen masat e përkohshme, gjykata do të ndërpresë masat e përkohshme mbi ankesën e njëjës prej palëve të cekura në nenin 12.11. Ndërprerja e tillë është pa pasoja për dorëzimin e mëtejshëm të propozimit sipas nenit 11 ose 12 lidhur me pasurinë.

12.13 Nëse kurrfarë procedure penale nuk zhvillohet në lidhje me pasurinë e cila i nënshtrohet masave të përkohshme sipas këtij neni, gjykata do të ndërpresë masat e përkohshme nëse nuk është parashtruar kurrfarë propozimi për konfiskim sipas nenit 11 brenda 90 ditësh nga data e aktvendimit të parë me të cilin urdhërohen masat e

përkohshme. Ndërprerja e tillë nuk ka pasoja për parashtrimin e ndonjë propozimi të mëtejshme sipas nenit 11 ose 12 lidhur me pasurinë.

12.14 Masa e përkohshme sipas këtij neni do të pushojë të jetë në fuqi pas përfundimit të procedurës në pajtim me nenin 11 të kësaj Rregulloreje.

Neni 13 Bashkëpunimi ndërkombëtar

Qëllimi dhe fushëveprimi i këtij neni

13.1 Autoritetet kompetente të Kosovës ndërmarrin sigurimin e masave më të gjera të mundshme të bashkëpunimit me autoritetet e shteteve të huaja me qëllim të këmbimit të informacionit, hetimeve dhe procedurave gjyqësore në lidhje me masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë dhe urdhrin për konfiskim lidhur me mjetet e pastrimit të parave dhe pasurinë e fituar me anë të veprës penale dhe me qëllim të ndjekjes së kryerësve të pastrimit të parave dhe aktivitetit terrorist.

13.2 Procedura për sigurimin e bashkëpunimit sipas nenit 13.1 është parashtruar në këtë nen dhe në dispozitat e tjera të tilla përkatëse të ligjit në fuqi të cilat nuk janë në kundërshtim me të.

13.3 Një kërkesë e bërë sipas këtij neni duhet të dërgohet përmes kanaleve diplomatike te Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, i cili e dërgon atë te drejtori i departamentit të drejtësisë.

Masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë

13.4 Për ruajtuar mundësinë e të pasurit në dispozicion të pasurisë në Kosovë që i nënshtrohet procedurës së konfiskimit që është themeluar ose ka pasur gjasë të themelohet në shtetet e huaja, pas propozimit të prokurorit publik dhe kërkesës së autoriteteve të shteteve të huaja, gjykata kompetente e qarkut mund:

(a) Të merr aktvendimin me të cilin urdhërohet masa e përkohshme për sigurimin e pasurisë ose

(b) Të zbatojë masën e përkohshme për sigurimin e pasurisë të shqiptuar nga gjykata e huaj kompetente.

13.5 Gjukata kompetente e qarkut mund të mbështetet në informacionin e parashtruar në kërkesë nga autoritetet e shteteve të huaja ku përshkruhet natyra e hetimit të ardhshëm ose procedura dhe parashtrimi i bazave të arsyeshme për të besuar se pasuria në fjalë do t'i nënshtrohet një urdhri për konfiskim në fund të procedurës.

13.6 Kur gjykata kompetente e qarkut vendos se masa e përkohshme për sigurimin e pasurisë së shqiptuar nga gjykata e huaj kompetente duhet të zbatohet, atëherë merr aktvendikmin në pajtim me nenin 12.4.

13.7 Përveç rasteve të parapara në nenet 13.4-13.6, neni 12 i kësaj Rregulloreje zbatohet përshtatshmërisht për procedurat me propozimin e Prokurorit Publik sipas nenit 13.4.

Urdhrat për konfiskim

13.8 Me propozimin e prokurorit publik dhe pas kërkesës nga autoritetet e shteteve të huaja, gjykata kompetente e qarkut me aktvendim mund të urdhërojë konfiskimin e pasurisë së ndodhur në Kosovë. Dispozitat e nenit 11 të kësaj Rregulloreje zbatohen përshtatshmërisht për procedurën e inicuar me propozimin e prokurorit publik, nëse asnjë gjykatë e huaj kompetente nuk ka marrë aktvendim për konfiskimin e pasurisë së tillë.

13.9 Me propozimin e prokurorit publik dhe pas kërkesës së autoriteteve të shtetit të huaj, gjykata kompetente e qarkut mund ta zbatojë aktvendimin e gjykatës së huaj kompetente për konfiskimin e pasurisë në Kosovë nëse gjykata e tillë është e bindur se:

- (a) Urdhri është i formës së prerë, nuk i nënshtrohet ankimit dhe nëse është dorëzuar kopja e vërtetuar e urdhrin të tillë me vulë dhe nënshkrim të gjykatës;
- (b) Personi ndaj të cilit apo lidhur me pasurinë e të cilit është lëshuar urdhri është njoftuar mbi procedurat jashtë Kosovës dhe se ka pasur mundësi të mbrojë interesin e tij në atë pasuri dhe
- (c) Zbatimi i urdhrin nuk do të jetë në kundërshtim me interesat e drejtësisë.

13.10 Njoftimi mbi propozimin për zbatimin e urdhrin të gjykatës së huaj kompetente do të bëhet në mënyrën e paraparë në nenin 11.3. Kërkesat për pretendim të pasurisë apo statusit të beneficuar mund të dorëzohen në pajtim me nenin 11.4.

13.11 Nëse personi apo entiteti që pretendon pronësinë a statusin e beneficuar publik konstaton se një apo më shumë nga kushtet e nenit 13.9 nuk janë plotësuar, gjykata mund ta zbatojë urdhrin duke marrë aktvendim për konfiskimin e pasurisë. Gjykata detyrohet nga zbulimi i fakteve përderisa ata janë shënuar në urdhrin e shtetit të huaj.

13.12 Nëse gjykata refuzon propozimin për zbatimin e urdhrin të gjykatës së huaj kompetente, e njofton prokurorin publik i cili brenda 30 ditëve mund të paraqesë propozim për konfiskim në pajtim me nenin 11 të kësaj Rregulloreje. Nëse pasuria është çështje e aktvendimit me të cilin urdhërohet masa e përkohshme për sigurimin e pasurisë, pas kërkesës nga autoritetet e shtetit të huaj, gjykata merr aktvendim për zgjatjen e masës së përkohshme për 30 ditë, përpos nëse prokurori publik pajtohet për ndërprerjen e masës.

13.13 Kur pasuria që duhet të konfiskohet me urdhrin e gjykatës së huaj kompetente është e shprehur në valutë tjetër pos asaj të lejuar për përdorim në Kosovë, shuma do të konvertohet në valutën e lejuar për përdorim në Kosovë, në bazë të shkallës së këmbimit zyrtar mbizotërues në datën kur gjykata në Kosovë e zbaton urdhrin.

13.4 Në varësi të neneve 13.9-13.13, neni 11 zbatohet përshtatshëm për procedurat e zbatimit të urdhrin për konfiskim të lëshuar nga gjykata e huaj.

Neni 14 Përgjashtim nga përgjegjësia

14.1 Pavarësisht nga dispozitat kundërtënëse të ligjit në fuqi, asnjë veprim për përgjegjësinë civile a penale dhe asnjë sanksion profesional nuk mund të ndërmerret ndaj personit apo entitetit bazuar vetëm në transmetimin e informatave, dorëzimin e raporteve apo veprimeve të tjera në mirëbesim në pajtim me këtë Rregullore, apo transmetimin vullnetar e informatave në mirëbesim lidhur me aktin apo transaksionin e dyshimtë, larjen e dyshimtë të parave apo financimin e dyshimtë të aktiviteteve terroriste në Qendër.

14.2 UNMIK-u është i përjashtuar nga përgjegjësia lidhur me veprimin ose mosveprimin e Qendrës apo të zyrtarëve të saj.

Neni 15 Sekreti profesional

15.1 Pavarësisht nga dispozitat kundërtënëse të ligjit në fuqi, sekreti profesional nuk mund të përdoret si arsye për refuzimin e sigurimit të informatave që:

- (a) Duhet zbuluar në pajtim me këtë Rregullore ose
- (b) Janë mbledhur dhe ruajtur në pajtim me këtë Rregullore, dhe kërkohen qoftë nga Qendra, qoftë nga policia lidhur me një hetim për larjen e parave të urdhëruar apo të kryer nën mbikëqyrjen e prokurorit publik apo gjyqtarit hetues.

15.2 Neni 15.1 është pa pasoja për nenin 2.7(b) dhe 6.9.

Neni 16 Njoftimi mbi këtë Rregullore

Njoftimi mbi këtë Rregullore do të lëshohet nga:

- (a) BPK-ja te bankat e regjistruara dhe te institucionet financiare;
- (b) UNMIK-u te OJQ-të e regjistruara dhe

(c) Nga OSBE-ja te partitë e regjistruara politike.

Neni 17
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të lëshojë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 18
Ligji në fuqi

Pos ku është thënë shprehimisht ndryshe brenda kësaj Rregulloreje, kjo Rregullore shfuqizon të gjitha ligjet në fuqi që janë në kundërshtim me të.

Neni 19
Hyrja në fuqi

Pos aty ku është thënë shprehimisht një datë e mëvonshme e hyrjes në fuqi në nene të caktuara, kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 mars 2004 dhe mbetet në fuqi për një periudhë fillestare prej dymbëdhjetë (12) muajsh. Pas shqyrtimit, kjo periudhë mund të vazhdohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Harri Holkeri
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Filename: RA2004_02
Directory: C:\Documents and Settings\rbajraktari1\My
Documents\gazette\2004\Regs\Albanian
Template: C:\Documents and Settings\rbajraktari1\Application
Data\Microsoft\Templates\Normal.dot
Title: ml99eng
Subject:
Author: Preferred Customer
Keywords:
Comments:
Creation Date: 2/18/2004 2:06 PM
Change Number: 2
Last Saved On: 2/18/2004 2:06 PM
Last Saved By: abegolli
Total Editing Time: 0 Minutes
Last Printed On: 2/18/2004 3:54 PM
As of Last Complete Printing
Number of Pages: 37
Number of Words: 12,634 (approx.)
Number of Characters: 72,014 (approx.)